

Agjencia Telegrafike Shqiptare, 5 gusht 2005

Intervistë me Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorin Pavel Vacek

Gazetare: Marsjola Duro

1. Duke marrë në konsideratë të gjitha të dhënat e deritanishme mbi procesin zgjedhor, a janë të pranueshme zgjedhjet e 3 korrikut në Shqipëri?

Nuk më takon mua që të bëj gjykime të tilla, por institucioneve shqiptare, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Kolegjit Zgjedhor. Vendimet e tyre duhen respektuar. Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve i ODIHR-it do të nxjerrë raportin e tij përfundimtar një muaj pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, por nuk është në praktikën e tij që të japë gjykime për atë që ju a quani pranueshmëri të zgjedhjeve.

2. Në vlerësimet tuaja të procesit zgjedhor në vend, cilësohet fakti se ky proces nuk ka përfunduar ende Çfarë prisni të ndryshojë deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të 3 korrikut?

Procesi zgjedhor vazhdon në të vërtet, sepse Kolegji Zgjedhor dhe KQZ-ja vazhdojnë shqyrtimin e ankimeve dhe apelimeve. Kolegji duhet të përfundojë gjykimin e apelimeve. KQZ-ja duhet të caktojë datën për përsëritjet e zgjedhjeve. Përsëritjet ka të ngjarë të jenë, e theksoj, ka të ngjarë të jenë, në një numër të kufizuar zonash. Shpresojmë që nuk do të ketë parregullsi në përsëritjet e zgjedhjeve dhe, për pasojë, nuk do të ketë ankime dhe apelime, gjë që duhet të lejojë KQZ-në të shpallë rezultatet përfundimtare pa vonesa të tjera.

3. Është pranuar tashmë nga faktori politik shqiptar, ndërkombëtar dhe nga Prezenca se me këto zgjedhje u hodh një hap përpara. Cili është ky hap?

Për mua, hapi më i madh përpara është hedhur nga votuesit shqiptarë, të cilët ushtruan të drejtën e tyre të votës në shkallë të gjerë dhe janë duke pritur me durim përfundimin e punës nga KQZ-ja dhe Kolegji. Rritja e shkallës së respektimit të ligjit dhe institucioneve është një shenjë e qartë përparimi dhe disipline qytetare. Pa dyshim, vlerësimi i përgjithshëm me detaje i zgjedhjeve do të jepet nga Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it dhe ai do të japë një panoramë të përzier të anëve të mira dhe të këqija.

4. Si e vlerësoni rolin e lidershit politik në procesin paszgjedhor në vend?

Unë shpresoj që ata të jenë këshilluar mirë që të ndjekin qëndrimin e qytetarëve, domethënë, të respektojnë ligjin dhe institucionet zgjedhore.

5. Ligji aktual zgjedhor dhe Prezenca kanë qenë nën kritikën e partive të vogla politike shqiptare, si dhe atë të mediave. Nëse, pas disa kohësh, do të zhvilloheshin përsëri zgjedhjet në Shqipëri, a do të ishte rezistent ky ligj?

Edhe nëse klasa politike zgjedh që të mbajë ligjin aktual, ka ende punë për të bërë për ta përmirësuar atë. Ka pasur rekomandime ndërkombëtare nga e kaluara që nuk u morën parasysh në reformën e mëparshme dhe ka edhe mësim të tjera që dolën nga procesi i numërimit të votave dhe ai i 3 korrikut. Megjithatë, unë kam dëgjuar partitë politike të flasin për një shkëputje nga sistemi aktual i bazuar në votimin e përzier mazhoritar dhe proporcional; në këtë rast, reforma e ardhshme do të jetë më shumë se thjesht përmirësime të Kodit Zgjedhor. Këto janë çështje që i takojnë parlamentit të ri, ne do të ishim të gatshëm të jepnim ndihmën tonë në këtë drejtim.

6. Cilat janë momentet më kryesore të procesit zgjedhor që nga dita e sotme deri në formimin e qeverisë së ardhshme që pritet të monitorohen nga ju?

Përsëritjet e zgjedhjeve duhet të vëzhgohen nga vëzhguesit ndërkombëtarë, por nuk do të jetë Prezenca e ngarkuar me këtë detyrë. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it do të jetë ai që do ta mbulojë këtë. Prezenca vetëm mund t'iu japë atyre mbështetje teknike. Unë mendoj se organizatat e vëzhguesve vendas do të jenë, gjithashtu, të interesuara që të riangazhohen për përsëritjet e zgjedhjeve. Shpresoj që këto përsëritje të mos njohin parregullsitë e 3 korrikut dhe të numërimit të votave.